faktikisht mund të jetë me leverdi për familjen. Transaksioni megjithatë ka dy aspekte që ia vlen të shqyrtohen në këtë drejtim. Duhet përcaktuar nëse pasuria po blihet me pasuri të përbashkëta dhe nëse fitimi i pasurisë ka kosto shoqëruese, që mund të bëhen barrë për pjesën e mbetur të pasurisë së fituar gjatë martesës. Që të dy bashkëshortët, pra, duhet të vihen plotësisht në dijeni për pjesën e pasurisë që po fitojnë, me qëllim që të shmangin mosmarrëveshjet në të ardhmen. Noteri duhet t'u kushtojë vëmendje të posaçme këtyre dy aspekteve dhe, nga ana e vet, duhet t'i vërë në dijeni bashkëshortët përfitues për gjasën e këtyre rrethanave. Vigjilenca e duhur është me rëndësi vendimtare në rastet e kontratave të shitjes dhe shkëmbimit. Kur transaksioni konsiston në dhurimin e një pasurie të paluajtshme, nuk ekziston ndonjë nevojë e posaçme për ushtrimin e vigjencës së duhur si e tillë, për shkak të pasojave të vetë karakterit të këtij transaksioni.

Përveç sa më sipër, noteri duhet t'i shënojë të dy bashkëshortët si pronarë të pasurisë së paluajtshme në kontratën e paraqitur për regjistrim, dhe ai/ajo në masën e përshtatshme i informon të dy bashkëshortët mbi regjistrimin në bashkëpronësi të pasurisë së paluajtshme që është fituar. Deklarimet e tyre duhet të përfshihen madje në aktin noterial. Pasi noteri i ka shënuar në kontratë emrat e të dy bashkëshortëve si palët përfituese, në përputhje me regjimin e pasurisë në bashkësi, vijon përkatësisht regjistrimi nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës i bashkëpronësisë së bashkëshortëve.



2.2 Pyetje

- A është i martuar personi?
- A ekziston ndonjë kontratë që përcakton regjimin pasuror martesor dhe, nëse ekziston, cila është pjesa për të cilën klienti dhe bashkëshorti/bashkëshortja kanë të drejtë?
- Në rastin kur regjimi pasuror martesor i zbatueshëm është ai i pasurisë në bashkësi, a e keni këshilluar bashkëshortin e palës përfituese mbi pasojat e fitimit të pasurisë objekt i regjimit pasuror martesor të pasurisë në bashkësi?
- A është informuar bashkëshorti tjetër mbi synimin për të fituar pasuri?
- A e jep pëlqimin bashkëshorti për një transaksion të tillë?
 - Nëse duhet, ftojeni bashkëshortin/en e klientit tuaj në kryerjen e transaksionit dhe në këtë rast:
 - Informojeni bashkëshortin/en e klientit tuaj mbi të drejtat dhe interesat e tij/të saj në pasurinë që do të blihet.
 - Informojeni bashkëshortin/en e klientit tuaj mbi të drejtat e tij/të saj për të dhënë pëlqimin me shkrim për transaksionin ose për ta refuzuar atë.
 - Informojeni klientin tuaj dhe bashkëshortin/en mbi kushtin e regjistrimit të pasurisë nga të dy bashkërisht.



2.3 Lista e dokumenteve/veprimeve

- ✓ Letërnjoftimi
- ✓ Certifikata familjare
- ✓ Certifikata e martesës
- ✓ Marrja nga kartela e pasurisë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës e informacionit/ekstraktit kadastral nga banka e të dhënave përmes internetit përpara 72 orëve të fundit
- ✓ Harta dhe planimetria e pasurisë
- ✓ Kontrata që përcakton regjimin pasuror martesor, nëse ka një të tillë, ose marrëveshja që ndryshon regjimin pasuror martesor të veçantë dhe verifikimi i regjistrimit të kontratës në regjistrin e gjendjes civile;
- ✓ Pëlqimi me shkrim nga bashkëshorti/ja
- ✓ Përfshirja e përshkrimit përkatës në kontratë, duke cituar si blerës/bashkëpronar bashkëshorten/in jo prezent, *ipso jure*, që ka fituar të drejta të pronësisë gjatë martesës
- ✓ Paraqitja e aktit noterial për regjistrim

3. Disponimi ose fitimi i pasurisë në rastin e zbatimit të ligjit për të huajt

3.1 Baza ligjore

Rregullat për caktimin e regjimit pasuror martesor të zbatueshëm, kur njëri prej bashkëshortëve është shtetas i huaj ose ka shtetësi të dyfishtë, sanksionohen në ligjin nr. 10 428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”. Ky ligj mbështetet në parimin e autonomisë që iu jepet bashkëshortëve për të përcaktuar ligjin e zbatueshëm për regjimin pasuror martesor të tyre me pajtim me anë të një akti noterial (ose ndonjë akti tjetër me vlerë të njëjtë). E drejta për të zgjedhur ligjin e zbatueshëm, sidoqoftë, është e kufizuar në alternativat që përcakton ligji. Është thelbësore në këtë fazë që noteri të tregojë kujdesin e duhur që t’i pyesë palët nëse kanë arritur mirëkuptim sa i takon caktimit të ligjit të zbatueshëm. Nëse një palë e tretë që hyn në një marrëdhënie kontraktuale me njërin prej bashkëshortëve, nuk di ose objektivist e ka të pamundur të dijë ekzistencën e një marrëveshjeje të tillë, për qëllime të marrëdhënive midis palës së tretë dhe bashkëshortëve, këta të fundit prezumohen si të martuar nën regjimin pasuror martesor të ligjit të zbatueshëm, që sanksionohet nga kriteret e lidhjes parashikuar në nenin 23 të ligjit. Në zbatim të këtij neni, në rast se bashkëshortët nuk kanë arritur mirëkuptim sa i takon përcaktimit të ligjit të zbatueshëm për regjimin pasuror martesor të tyre, ligji i zbatueshëm përcaktohet nga marrëdhëniet personale midis bashkëshortëve. Në mungesë të mirëkuptimit midis palëve, ligji i zbatueshëm është ai i shtetësisë së përbashkët të bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët kanë shtetësi të ndryshme, zbatohet ligji i shtetit, në të

cilin ata kanë vendqëndrimin e përbashkët. Së fundi, nëse ligji i zbatueshëm nuk mund të përcaktohet bazuar mbi këto kritere, zbatohet ligji i shtetit, me të cilin marrëdhënia bashkëshortore ka lidhjen më të ngushtë.

Pasi cakton ligjin e zbatueshëm dhe llojin e regjimit pasuror martesor, noteri duhet të përcaktojë se deri në çfarë mase bashkëshorti, që tjetëron një pasuri, ka të drejtë ta disponojë pasurinë e paluajtshme, duke iu referuar ligjit përkatës. Në rast se nevojitet pëlqimi i bashkëshortit/es tjetër, noteri duhet të sigurojë praninë dhe pëlqimin e bashkëshortit/es përpara se noteri të kryejë transaksionin.

Pasi caktohet regjimi pasuror martesor, noteri i referohet ligjit që rregullon nënshkrimin e kontratës midis bashkëshortit/bashkëshortëve dhe palës së tretë. Ligji bën dallimin midis ligjit që rregullon vlefshmërinë e formës së kontratës, dhe ligjit që rregullon vlefshmërinë e përmbajtjes së kontratës. Sa i takon formës së një veprimi juridik, siç është një kontratë shitjeje/shkëmbimi/dhurimi, ligji nr. 10 428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” përcakton se: “Veprimi juridik, i cili ka për objekt sende të paluajtshme, rregullohet nga ligji i shtetit, në të cilin ndodhet sendi i paluajtshëm” (neni 18, para. 3). Në një rast të tillë, pra, palëve nuk u jepet asnjë lloj autonomie. Nëse pasuria e paluajtshme që shitet/dhurohet/shkëmbehet ndodhet në Republikën e Shqipërisë, kontrata duhet të hartohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil shqiptar. Në nenin 83 të Kodit Civil thuhet se: “Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm”. Lidhur me përmbajtjen e kontratës, ligji nr. 10 428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” u jep autonomi palëve, të cilat lidhin kontratë, për të zgjedhur ligjin e zbatueshëm për të gjithë ose për një pjesë të veçantë të kontratës (neni 45). Vetëm në mungesë të një marrëveshjeje, një kontratë në lidhje me të drejtat mbi pasurinë e paluajtshme rregullohet nga ligji i vendit ku ndodhet pasuria (neni 46, para.1-c). Sa i takon të drejtës së posedimit nga një palë e tretë të pasurisë së fituar, ligji parashikon se pronësia mbi pasurinë e paluajtshme rregullohet nga ligji i shtetit në të cilin ndodhet sendi (neni 36, para. 1).

Me qëllim që palët t’i kuptojnë dhe të jenë plotësisht të vetëdijshme sa i takon pasojave të transaksionit që kryhet, noteri duhet t’i vërë të dyja palët në dijeni për ligjin e saktë të zbatueshëm për regjimin pasuror martesor, vlefshmërinë e formës së kontratës së shitjes/shkëmbimit/dhurimit, vlefshmërinë e përmbajtjes së kontratës, si dhe për të drejtat e pronësisë që burojnë nga ky transaksion. Më e rëndësishmja, noteri duhet t’i informojë palët përfituese mbi të drejtën për të regjistruar pasurinë në bashkëpronësi, nëse regjimi pasuror martesor i zbatueshëm është ai i pasurisë në bashkësi.



3.2 Pyetje

- A është personi, që synon të përfundojë një transaksion, shtetas i huaj apo shtetas me shtetësi të dyfishtë?
- A është personi, që synon të përfundojë një transaksion, i martuar me shtetas/shtetase të huaj?
- A ndodhet pasuria objekt i transaksionit në Republikën e Shqipërisë?
- A është marrë pëlqimi nga bashkëshorti/ja për shitjen e pasurisë në rast se kërkohet nga ligji i zbatueshëm për regjimin pasuror martesor?

- Në rast se bashkëshorti/ja e personit që tjetëron pasurinë jep pëlqimin e vet për shitjen e pasurisë së paluajtshme, a është informuar ai/ajo mbi pasojat e transaksionit bazuar në ligjin e zbatueshëm për regjimin pasuror martesor të bashkëshortëve?
- Në rast se regjimi pasuror martesor i zbatueshëm është ai i pasurisë në bashkësi, a e keni këshilluar bashkëshortin/en e palës përfituese për pasojat e fitimit të pasurisë dhe të drejtën e tij/të saj për ta regjistruar pasurinë në bashkëpronësi?



3.3 Lista e dokumenteve/veprimeve

- ✓ Letërnjoftimi/Pasaporta/pasaporta ndërkombëtare
- ✓ Certifikata e martesës
- ✓ Marrja nga kartela e pasurisë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës e informacionit/ekstraktit kadastral nga banka e të dhënave përmes internetit jo përpara 72 orëve të fundit
- ✓ Harta dhe planimetria e pasurisë
- ✓ Marrëveshja dhe/ose kontrata midis bashkëshortëve për zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm për regjimin pasuror martesor të tyre (nëse ka një të tillë)
- ✓ Pëlqimi i bashkëshortit/es, nëse kërkohet nga ligji i zbatueshëm
- ✓ Marrëveshja midis palëve, të cilët nënshkruajnë kontratën që përcakton ligjin e zbatueshëm, i cili rregullon përmbajtjen e kontratës së shitjes/shkëmbimit/dhurimit sa i takon një pasurie të paluajtshme (nëse ka një të tillë)
- ✓ Pasqyrimi në aktin noterial i emrit të bashkëshortit/es nëse ligji i zbatueshëm mbështetet në regjimin pasuror martesor të pasurisë në bashkësi

II. TRASHËGIMIA



Në kuadrin ligjor shqiptar, noteri luan një rol qendror në mbrojtjen e interesave dhe garantimin e respektimit të së drejtës së bashkëshortit/es pasjetues/e dhe të bijave të personit të vdekur, meqenëse noterët kanë kompetencën për të lëshuar dëshminë e trashëgimisë dhe kryejnë detyra të tjera si pasojë e lëshimit dhe ruajtjes së testamentit të testatorit. Njësoj si në rastin e transaksioneve dhe procedurave të tjera kur rrezikohen të drejtat e grave, noteri duhet të përfshihet në mënyrë proaktive për informimin e trashëgimtarëve, ndërgjegjësimin lidhur me të drejtat dhe detyrat e tyre, mbrojtjen e të drejtave që u jep ligji kategorive të veçanta të trashëgimtarëve, si dhe dhënien e zgjidhjeve kur ato çmohen të nevojshme dhe të përshtatshme.

Dispozitat e Kodit Civil parashikojnë dy mënyra për transferimin e pasurisë së personit të vdekur tek trashëgimtarët: transferimi i pasurisë me ligj dhe transferimi i pasurisë me testament. Trashëgimia me ligj ndodh kur testatori nuk ka bërë testament, kur testamenti është plotësisht ose pjesërisht i pavlefshëm apo kur testatori ka lënë një testament që i referohet vetëm një pjese të pasurisë së tij/të saj trashëgimore (Gjykata e Lartë, Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara nr. 1, datë 19.02.2014). Edhe në rastet kur testatori e ka disponuar pasurinë e tij/të saj trashëgimore me testament, zbatohen garanci ligjore me qëllim që të mos cenohet pjesa e trashëgimtarëve testamentarë. Megjithatë, pavarësisht nga kuadri ligjor ekzistues, situata reale tregon ekzistencën e një mendësie ngulmuese dhe të zakonave që u mohojnë bijave apo bashkëshorteve pasjetuese të drejtat që të gëzojnë të drejta të barabarta të trashëgimisë. Kjo është arsyeja pse noteri jo vetëm duhet të sigurojë zbatimin si duhet të legjislacionit në fuqi sa i takon procedurave të trashëgimisë, por gjithashtu duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë mbrojtjes së pjesës së ligjshme dhe të drejtë të pasurisë trashëgimore që u kalon trashëgimtarëve femra.

Përveç kësaj, pa cenuar vullnetin e palëve dhe duke pranuar se noteri nuk është këshilltar për tatimet, noteri duhet t'i vërë trashëgimtarët në dijeni për tatimet shoqëruese që aplikohen lidhur me të drejtat e trashëgimisë, siç përcaktohet në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar), që, në parim, pasurinë e fituar me trashëgimi e përfshin në fushën e tatimit të zbatueshëm mbi të ardhurat. Përfshihen rastet e kalimit vetëm një herë të së drejtës së pronësisë mbi apartamentin ose tokën brenda familjes midis bashkëshortëve dhe fëmijëve, në favor të një përfituesi me anë të dhurimit ose heqjes dorë nga pasuria trashëgimore (neni 8, para. 1, neni 11, para. 1).

Gjatë përfundimit të këtyre transaksioneve noterët kanë detyrimin që të zbatojnë ligjin mbi mbrojtjen e të dhënave. Noteri duhet t'i vërë të dhënat mbi përmbajtjen e akteve noteriale në dispozicion vetëm të personave, në emër të të cilëve janë mbyllur këto transaksione, përfaqësuesve të tyre me prokurë, trashëgimtarëve të tyre dhe personave që fitojnë të drejta ose heqin dorë nga detyrimet prej aktit noterial (ligji nr. 110/2018 "Për noterinë", neni 61, para. 1f). Cenimi i konfidencialitetit dhe i sekretit profesional përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë dhe mund të shërbejë si bazë për iniciimin e procedurave disiplinore ndaj noterit (Kodi i Etikës së Noterëve, neni 24, para. b).

Së fundi, vlen të vërehet se regjimi i trashëgimisë i rregulluar me Kodin Civil nuk shtrihet tek çiftet bashkëjetuese.

1. Përcaktimi i statusit personal të personit të vdekur

1.1. Baza ligjore

Sipas Kodit Civil, trashëgimia çelet kur vdes trashëgimlënësi (neni 318). Trashëgimia çelet në kohën kur, sipas verifikimit fizik apo përcaktimit me vendim gjyqësor të shpalljes së personit të vdekur, trashëgimlënësi konsiderohet i vdekur. Përcaktimi i këtij momenti është me rëndësi të veçantë praktike pasi ai përcakton të drejtat dhe kohën e transferimit të së drejtës së trashëgimisë tek rrethi i trashëgimtarëve, të cilët thirren në trashëgimi. Kjo kohë përcakton gjithashtu ligjin e zbatueshëm sa i takon efekteve në vijim të çeljes së trashëgimisë (Gjykata e Lartë, Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara nr. 24, 2002).

Përpara hartimit të dëshmisë së trashëgimisë noteri duhet të verifikojë dy fakte specifike:

Së pari, noteri duhet të verifikojë nëse personi i vdekur ka qenë i martuar në kohën e vdekjes. Nëse ka qenë i martuar, pasuria trashëgimore objekt i trashëgimisë duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë regjimin pasuror martesor të bashkëshortëve dhe pjesën takuese të bashkëshortit pasjetues. Në rast divorci, noteri duhet të përqendrohet në ruajtjen e të drejtave dhe të pjesës së ish bashkëshortit, nëse pasuria është fituar gjatë martesës në regjimin e pasurisë në bashkësi, pavarësisht nëse ajo është regjistruar vetëm në emrin e personit të vdekur. Noteri, në rastet kur konstaton se pasuria e paluajtshme e përfituar gjatë martesës, për të cilën kërkohet të kryhet akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, figuron e regjistruar vetëm në emrin e njërit prej bashkëshortëve dhe bashkëshorti i prezumuar bashkëpronar ka ndërruar jetë, kërkon lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për bashkëshortin e prezumuar bashkëpronar, si edhe regjistrimin e trashëgimtarëve në certifikatën pronësisë së pasurisë për të cilën kërkohet të kryhet tjetërsimi ose njohja e pasurisë (ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, neni 127, para 2).

Pas ndarjes së pjesës takuese të bashkëshortit pasjetues, gjejnë zbatim rregullat e trashëgimisë ligjore në rast se personi i vdekur nuk e ka disponuar pasurinë e tij/të saj trashëgimore me testament. Në zbatim të Kodit Civil, në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta (neni 361). Kodi Civil nuk e bën diferencimin midis të drejtave të bijve dhe të bijave për të trashëguar. Kur nuk ka trashëgimtarë të tjerë të radhës së parë përveç bashkëshortit, në trashëgimi thirren trashëgimtarët e radhës pasardhëse, të parashikuar në nenet 362-363 të Kodit Civil (prindërit dhe personat në ngarkim me aftësi të kufizuara, gjyshi dhe gjyshja, vëllezërit dhe motrat dhe fëmijët e këtyre të fundit). Në çdo rast bashkëshorti merr ½ pjesë të trashëgimit (nenet 361–366). Kjo tregon se bashkëshorti ka të drejtë të fitojë një pjesë të pasurisë së fituar gjatë martesës sipas regjimit të zbatueshëm, por ka gjithashtu të drejtë të marrë një pjesë specifike të pasurisë trashëgimore të personit të vdekur.

Së dyti, noteri duhet të konfirmojë pasurinë trashëgimore objekt të procedurave të trashëgimisë. Për këtë qëllim, noteri duhet të lejohet të hyjë në bankën e të dhënave përmes internetit të regjistrimit kadastral me qëllim konsultimin e kartelave të pasurive. Përveç kësaj, noteri nuk duhet të kufizohet në pasuritë e përmendura në testament. Lidhur me trashëgiminë me testament, për shembull, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë nënvizuar rëndësinë e kryerjes së hetimeve nëse testatori zotëronte pasuri të tjera në kohën e vdekjes, në mënyrë që të përcaktohet saktësisht nëse testatori e ka shprehur dëshirën e fundit për të gjitha pasuritë që kishte në kohën e vdekjes, apo nëse ka patur pasuri të tjera (të përfituara) që nuk janë përmendur në testament (Gjykata e Lartë, Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara nr. 1, datë 18.12.2014).



1.2 Pyetje

- A ka qenë i martuar personi i vdekur në kohën e vdekjes?
- A ka qenë i martuar personi i vdekur në kohën kur ka fituar pasurinë që është pjesë e pasurisë trashëgimore?
- A ka patur personi i vdekur kontratë martesë me bashkëshortin pasjetues/ish bashkëshortin?
- A ka lënë testament personi i vdekur?
- A i përmbush testamenti kushtet e rezervës ligjore mbi të drejtat e trashëgimisë dhe pjesën e trashëgimisë të trashëgimtarëve testamentarë?
- A ka fituar personi i vdekur gjatë martesës pasuri objekt i bashkëpronësisë me bashkëshortin pasjetues?
- Cila është pjesa e pasurisë që i takon personit të vdekur?
- A është pasuria e paluajtshme objekt i trashëgimisë që ndodhet në Shqipëri apo gjetkë?



1.3 Lista e dokumenteve/veprimeve

- ✓ Certifikata e vdekjes së testatorit
- ✓ Certifikata e martesës
- ✓ Vendimi i divorcit
- ✓ Vendimi për pjesëtimin e pasurisë së fituar gjatë martesës në rast divorci (nëse është e ndarë)
- ✓ Kontrata që përcakton regjimin pasuror martesor
- ✓ Ekstrakt nga regjistri kadastral për pasuritë e paluajtshme
- ✓ Kontratë/akt/vendim për fitimin e pasurisë së paluajtshme

2. Detyra për të identifikuar, informuar dhe ftuar të gjithë trashëgimtarët në procedurat e trashëgimisë

2.1 Baza ligjore

Noteri duhet të sigurojë identifikimin dhe njoftimin e të gjithë trashëgimtarëve, të cilët kanë interes në lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë. Sipas ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, noteri, gjatë hartimit të dëshmisë testamentare, arsyeton në lidhje me ekzistencën e trashëgimtarëve që përfitojnë nga rezerva ligjore dhe përfshin këta trashëgimtarë si trashëgimtarë testamentarë, duke përcaktuar e specifikuar qartë edhe pjesët takuese të tyre. Përveç kësaj, noteri duhet të regjistrojë të gjithë procesin duke administruar të gjithë procesverbalet e çelura (neni 113, para. 5, dhe neni 118, para. 5). Informacioni që iu jepet palëve lidhur me ekzistencën dhe pjesëtimin e pasurisë trashëgimore të personit të vdekur është i dobishëm për shmangien e mosmarrëveshjeve të ardhshme.

Trashëgimtari, gjithsesi, ruan të drejtën që të kërkojë me padi në gjykatë njohjen e tij/të saj si trashëgimtar (Kodi Civil, neni 349). Përveç kësaj, kur nuk dihet a ka trashëgimtarë ose kur trashëgimtarët mungojnë dhe nuk ka lajme për ata ose kur trashëgimtarët ligjorë apo testamentorë kanë hequr dorë nga trashëgimi dhe nuk dihen trashëgimtarët e tyre, noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimi, *ex officio*, ose me kërkesën e çdo të interesuari, emëron një kujdestar të trashëgimit. Shkurtimi i aktit noterial të emërimit të kujdestarit shpallet në Fletoren Zyrtare (Kodi Civil, neni 344).

Në këtë fazë të procedurës, noteri duhet të japë informacion ligjor mbi hapat që do të kryhen, dokumentet e nevojshme që kërkohen, të drejtat dhe detyrimet e çdo trashëgimtari, si dhe mbi pasojat e veprimeve të tyre.



2.2 Pyetje

- A ka lënë testament personi i vdekur?
- A ka patur bashkëshort/e personi i vdekur?
- A ka patur fëmijë personi i vdekur?
- A ka patur personi i vdekur prindër, vëllezër, motra dhe farefis tjetër?
- Cila është adresa e tyre e saktë?
- A banon ndokush prej tyre jashtë shtetit dhe ku?



2.3 Lista e dokumenteve/veprimeve

- ✓ Inspektimi i regjistrit të testamenteve
- ✓ Letërnjoftimi për çdonjërën prej trashëgimtarëve
- ✓ Certifikata e lindjes për çdonjërën prej trashëgimtarëve
- ✓ Certifikata e vdekjes e personit të vdekur
- ✓ Prokurë e posaçme në rast përfaqësimi
- ✓ Akti i emërimit të kujdestarit, nëse kërkohet

3. Mbrojtja e të drejtave dhe interesave të trashëgimtarëve testamentorë në rastin e testamentit

3.1 Baza ligjore

Përveç dispozitave ligjore mbi trashëgiminë, Kodi Civil rregullon të drejtën për disponimin e pasurisë trashëgimore *post mortem* me testament. Testamenti mund të bëhet në dy forma: ollograf dhe me akt noterial. Kodi Civil, megjithatë, parashikon një autonomi relativisht të kufizuar të testatorit për disponimin e pasurisë së vet trashëgimore. Sipas Kodit Civil, trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim (neni 361, para. 2), si dhe trashëgimtarët e tij të tjerë të paaftë për punë në qoftë se thirren në trashëgim, dhe as të cenojë me testament në çdo mënyrë qoftë, pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar (neni 379). Kur testatori disponon me testament një uzufrukt ose një rentë jetësore, të ardhurat e të cilave kalojnë ato të pjesës së disponueshme, trashëgimtarët që kanë të drejtë në rezervën ligjore mund të ekzekutojnë këtë disponim ose të heqin dorë nga të drejtat mbi pjesën e disponueshme (neni 380). Sipas Kodit Civil, testamenti është i pavlefshëm kur disponimi me testament i trashëgimlënësit i përjashton nga trashëgimia ligjore trashëgimtarët e tij të mitur ose të paaftë për punë ose cenon pjesën e tyre ligjore (neni 407).

Në fazat e hershme të hartimit të testamentit noteri mund të parandalojë shkeljen e rezervës ligjore. Gjatë përpilimit të testamentit me akt noterial, noteri njofton testatorin kur ndonjë disponim i testamentit vjen në kundërshtim me ligjin. Noteri, sidoqoftë, nuk mund të hyjë në shqyrtimin e çështjeve konkrete, si rrethi i personave të caktuar në testament si trashëgimtarë, qenia e trashëgimlënësit pronar i pasurisë së lënë në trashëgim dhe çështje të tjera të kësaj natyre (ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, neni 109, para. 2). Noteri, gjithsesi, refuzon përpilimin e aktit nëse disponimet e trashëgimlënësit nuk respektojnë elementet e vlefshmërisë së testamentit, sipas parashikimeve të Kodit Civil (ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, neni 109, para. 4). Këto dispozita garantojnë mbrojtjen e të drejtave të trashëgimtarëve të cenueshëm, siç është bashkëshorti në pension (Kodi Civil, neni 371) ose pjesa e të miturit. Noteri duhet t’i kushtojë vëmendje kur përcakton nëse trashëgimtarët e mitur kanë fituar madhorinë në kohën e çeljes së trashëgimisë; vlefshmëria e testamentit që i përjashton ata nga trashëgimia nuk cenohet (A. Nuni dhe L. Hasneziri).

Kur nis procesin e lëshimit të dëshmime të trashëgimisë, noteri sërish duhet të kontrollojë nëse testamenti përmbush kërkesat e Kodit Civil. Noteri verifikon një për një trashëgimtarët që përfitojnë nga rezerva ligjore, dhe i përfshin ata në dëshminë e trashëgimisë. Noteri, gjatë hartimit të dëshmisë testamentare, arsyeton në lidhje me ekzistencën e trashëgimtarëve që përfitojnë nga rezerva ligjore dhe i përfshin këta trashëgimtarë si trashëgimtarë testamentarë, duke përcaktuar e specifikuar qartë edhe pjesët takuese të tyre (ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, neni 113, para. 4). Në rast se në testament i ka përjashtuar fëmijët e tij/të saj, testatori, sidoqoftë, nuk mund t'i përjashtojë nipërit dhe mbesat, nëse këta të fundit në kohën e çeljes së trashëgimisë kanë qenë të mitur. Nëse cenohet pjesa e tyre, mund të cenohet vlefshmëria e testamentit (Gjykata e Lartë, Vendimi Unifikues nr. 1, 2014).

Kur disponimi me testament është i pavlefshëm, noteri, me vendim të arsyetuar, e shpall të pavlefshëm testamentin dhe vijon me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore. Në rast se shpall të pavlefshme vetëm disa nga disponimet e testamentit, dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet vetëm për atë pjesë të disponimeve të testamentit që shpallen të pavlefshme (ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, neni 111, para. 4). Kjo ndodh kur, ndër të tjera, për shkak të shkeljeve të pjesës së trashëgimtarëve testamentarë, noteri e shpall testamentin plotësisht ose pjesërisht të pavlefshëm.

Padia për pavlefshmërinë e testamentit ose të disponimit me testament mund të ngrihet nga trashëgimtari dhe nga çdo tjetër person i interesuar brenda tre vjetëve nga çelja e trashëgimisë (Kodi Civil, neni 411).



3.2 Pyetje

- A ka lënë testament personi i vdekur?
- A i përmbush testamenti kushtet paraprake të ligjit?
- A është përpiluar testamenti në formë ollografe apo me akt noterial?
- A ekziston ndonjë testament tjetër?
- A janë shkelur të drejtat e shkruara të trashëgimtarëve bazuar në rezervën ligjore? Nëse po:
 - Informojini trashëgimtarët mbi të drejtat e shkruara që do të aplikohen
 - Informojini ata mbi pasojat e moskundërshtimit të testamentit
 - Informojini ata mbi kohën e kundërshtimit të testamentit
- A e pranojnë të gjithë trashëgimtarët trashëgiminë apo a heqin të gjithë dorë prej saj?
- A e kundërshton ndonjëri prej trashëgimtarëve përmbajtjen e testamentit?



3.3 Lista e dokumenteve/veprimeve

- ✓ Testamenti i personit të vdekur
- ✓ Certifikata familjare e trashëgimtarit
- ✓ Dëshmia e trashëgimisë
- ✓ Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia

4. Informimi i bashkëshortit pasjetues se ai/ajo mund të kërkojë ndarjen e pjesës së vet në pasurinë e fituar gjatë martesës nga pasuria trashëgimore e personit të vdekur

4.1 Baza ligjore

Kur bëhet pjesëtimi i pasurisë trashëgimore të personit të vdekur, është me rëndësi shumë të madhe që të ndiqen hapat e duhura për ndarjen e pasurisë së bashkëshortit pasjetues, që është fituar gjatë martesës, nga ajo pasuri trashëgimore. Kodi Civil dhe ligji nr. 110/2018 “Për noterinë” parashikojnë një bazë të qëndrueshme ligjore për të paraprirë ndonjë veprim të noterit, që mund të cenojë të drejtat e bashkëshortëve pasjetues të fituara gjatë martesës. Kodi Civil i jep të drejtën bashkëshortit pasjetues të kërkojë pjesën që i takon në pasurinë e përbashkët të fituar me punë nga bashkëshortët gjatë martesës (Kodi Civil, neni 358). Ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, gjithashtu, sanksionon se dëshmia e trashëgimisë duhet të përmbajë llojin e regjimit pasuror martesor të testatorit dhe bashkëshortit pasjetues (neni 112). Përpara se të përcaktojë vlerën e pasurisë trashëgimore që do t’u kalojë trashëgimtarëve, noteri fillimisht duhet të ndajë nga pasuria trashëgimore pjesën e pasurisë që i përket bashkëshortit pasjetues, që është fituar gjatë martesës, në përputhje me regjimin pasuror martesor, pavarësisht nëse emri i bashkëshortit pasjetues është i regjistruar në të dhënat e kadastrës. Pasi identifikohet dhe ndahet pjesa e bashkëshortit pasjetues, pjesa e mbetur që është në bashkëpronësi të bashkëshortëve dhe pasuria vetjake e personit të vdekur bëhen pjesë të pasurisë trashëgimore. Më pas, bashkëshorti pasjetues ka njëloj të drejtë të marrë një pjesë në pasurinë trashëgimore të personit të vdekur ashtu si trashëgimtarët e tjerë të së njëjtës radhë.

Për finalizimin e të gjithë procesit duke ruajtur plotësisht të drejtat e bashkëshortit pasjetues, sipas ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, në aktin e trashëgimisë noteri parashikon që kërkuesi, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, duhet të depozitojë në institucionin përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme (Agjencia Shtetërore e Kadastrës) një kopje të dëshmisë së trashëgimisë. Noteri duhet detyrimisht t’i bashkëlidhë aktit përkatës certifikatën/atat martesore të bashkëshortit/ bashkëshortes pasjetues/e (neni 112, para. 3).



4.2 Pyetje

- A ka qenë i martuar personi i vdekur?
- Kur është fituar pasuria?
- A ka qenë i martuar personi i vdekur në kohën e fitimit të pasurisë së paluajtshme?
- A është pasuria e paluajtshme objekt i bashkëpronësisë apo është pasuri vetjake që i takon vetëm njërit prej bashkëshortëve?



4.3 Lista e dokumenteve/veprimeve

- ✓ Certifikata e martesës
- ✓ Ekstrakti përmes internetit i kartelës së pasurisë që përfshihet në regjimin pasuror martesor
- ✓ Një dokument që tregon fitimin e mëparshëm të pasurisë
- ✓ Kontrata midis bashkëshortëve që përcakton regjimin e zbatueshëm për pasurinë e fituar gjatë martesës
- ✓ Ndarja e pjesës së bashkëshortit nga pasuria trashëgimore, e përfshirë në dëshminë e trashëgimisë

5. Informimi i pjesëtarit pasjetues të familjes se ai/ajo mund t'i ruajë të drejtat e përdoruesit mbi pasurinë e paluajtshme në varësi të miratimit nga të gjithë bashkëtrashëgimtarët

5.1 Baza ligjore

Legjislacioni shqiptar nuk iu njeh në mënyrë të shprehur bashkëshortit pasjetues dhe/ose fëmijëve ndonjë të drejtë të veçantë të përdoruesit për jetë, as ndonjë të drejtë të parablerjes në raste të tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme pjesë e pasurisë trashëgimore të personit të vdekur. Në procesin e pjesëtimit të pasurisë trashëgimore, sidoqoftë, noteri në mënyrë proaktive mund t'i vërë trashëgimtarët në dijeni për të drejtën për t'ia dhënë të tilla drejta të përdoruesit bashkëshortit pasjetues dhe/ose fëmijëve të mitur, duke e ruajtur ende të paprekur pjesën e tyre të trashëgimisë. Dhënia e të drejtave të përdoruesit është veçanërisht e rëndësishme kur ekziston mundësia që bashkëshorti dhe/ose fëmijët të mbeten të pastrehë.

Sipas Kodit Civil, nëse trashëgimtarët nuk bien dakord për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore, noteri i ofron trashëgimtarëve këshilla dhe mundësi ligjore për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore midis tyre. Noteri i sqaron ata për të drejtat dhe detyrat, si dhe i paralajmëron për pasojat që vijnë nga nënshkrimi i marrëveshjes, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre nga mosdijenja e ligjit (Kodi Civil, neni

354). Pikërisht gjatë kësaj procedure, noteri mund të parashtrojë opsione sa i takon përdorimit të shtëpisë së familjes të bashkëshortit pasjetues dhe fëmijëve, ndërsa vazhdon ende të mbrojë të drejtat e trashëgimisë të trashëgimtarëve të tjerë.



5.2 Pyetje

- A është pasuria që duhet të pjesëtohet, vendqëndrimi kryesor i ndonjërit prej bashkëtrashëgimtarëve, siç është bashkëshorti i personit të vdekur dhe bijat dhe bijtë e tij/të saj?
- A janë dakord bashkëtrashëgimtarët t'i kalojnë të drejtat e përdoruesit për jetë mbi pasurinë?



5.3 Lista e dokumenteve/veprimeve

- ✓ Certifikata familjare
- ✓ Deklarata për pranimin e trashëgimisë dhe pajtimin e trashëgimtarëve me përbërjen e të drejtave të përdoruesit për jetë para noterit

6. Informimi i trashëgimtarëve mbi pasojat e heqjes dorë nga trashëgimia

6.1 Baza ligjore

Trashëgimtarët mund të vendosin që të heqin dorë nga pjesa e tyre në pasurinë trashëgimore të trashëguar nga personi i vdekur. Heqja dorë nga trashëgimia konsiston në deklarimin e njëanshëm nga një trashëgimtar lidhur me heqjen dorë nga pjesa e vet në pasurinë trashëgimore të personit të vdekur (A. Nuni dhe L. Hasneziri). Ky proces ka domethënie të veçantë po të mbahet parasysh modeli ekzistues në shoqërinë shqiptare të trashëgimtareve femra, që heqin dorë nga pjesa e tyre në pasurinë trashëgimore, sidomos të motrave në favor të vëllezërve të tyre. Ky model lidhet sidomos me praktikën e vjetra të së drejtës zakonore që nuk njih të drejtat e trashëgimisë të bashkëshorteve dhe bijave (UN Women). Kjo është arsyeja pse noteri duhet të sigurohet që akti i heqjes dorë të bazohet në vullnetin e lirë të trashëgimtarit dhe të bëhet pa asnjë lloj detyrimi apo ndërhyrjeje nga trashëgimtarët të tjerë ose palë të treta. Noteri duhet të shqyrtojë nga afër arsyet thelbësore të një vendimi të tillë, pa cenuar statusin e tij/të saj neutral.

Noteri duhet të njoftojë trashëgimtarët se cilat janë pasojat e heqjes dorë nga trashëgimia, dhe se e drejta për të hequr dorë nga trashëgimia është e kufizuar në kohë. Trashëgimtarët mund të heqin dorë nga pjesa e tyre vetëm brenda tre muajve nga çelja e trashëgimisë dhe, kur trashëgimtari është jashtë shtetit, jo më vonë se gjashtë muaj (Kodi Civil, neni 335, para. 1). Kur nuk dihet a ka trashëgimtarë, ose kur trashëgimtarët mungojnë dhe nuk ka lajme për ta, noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, *ex officio*, ose me kërkesën e çdo të interesuari, cakton një afat, jo më pak se gjashtë muaj nga çelja e trashëgimisë, brenda të cilit ata duhet të deklarojnë nëse heqin dorë nga trashëgimi. Në qoftë se brenda këtij afati nuk bëhet ndonjë

II. TRASHËGIMIA

deklarim i tillë, prezumohet se trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë (Kodi Civil, neni 336). Megjithatë, nuk mund të hiqet dorë nga trashëgimi, kur gjatë afatit tre- dhe gjashtëmuor, trashëgimtari me veprimet e tij është sjellë si trashëgimtar, përveç kur kryhen veprime për të ruajtur pasurinë trashëgimore (Kodi Civil, neni 338). Të sjellurit si trashëgimtar mund të konsistojë në shlyerjen e borxheve, në grumbullimin e përfitimeve nga pjesa e trashëguar e pasurisë trashëgimore, në shitjen ose dhurimin e pjesës së pasurisë trashëgimore të trashëguar (A. Nuni dhe L. Hasneziri). Noteri, për më tepër, duhet të sigurojë që trashëgimtarët të kuptojnë se pasi heqin dorë nga pjesa e tyre e trashëgimisë, nuk mund ta shfuqizojnë deklarinimin e tyre (Kodi Civil, neni 339), ose të heqin dorë vetëm nga një pjesë e pjesës së tyre të trashëgimisë.

Kodi Civil sanksionon se heqja dorë nga trashëgimia duhet të bëhet me deklaratë të shkruar, që regjistrohet te noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, ose me deklaratë noteriale të redaktuar nga noteri. Heqja dorë mund të bëhet edhe me anë të një përfaqësuesi të pajisur me prokurë të posaçme, që i referohet në mënyrë specifike ushtrimit të së drejtës për të hequr dorë nga trashëgimia (Kodi Civil, neni 333). Me kërkesën e personit që kërkon të heqë dorë nga trashëgimia, noteri, në bazë të kërkesave të Kodit Civil, harton deklaratën noteriale në emër të kërkuesit, për heqjen dorë nga trashëgimia. Në rastin kur nuk është lëshuar dëshmia e trashëgimisë, trashëgimtari, brenda afatit të caktuar, deklaron heqjen dorë nga trashëgimia me një deklaratë noteriale dhe, më pas, noteri lëshon dëshminë e trashëgimisë duke respektuar parashikimet e Kodit Civil për zëvendësimin e trashëgimtarit që heq dorë nga trashëgimia. Në rastin kur është lëshuar më parë dëshmia e trashëgimisë dhe trashëgimtari kërkon të heqë dorë brenda afatit ligjor, atëherë trashëgimtari harton deklaratën noteriale për heqjen dorë nga trashëgimia. Pas hartimit të deklaratës noteriale për heqje dorë nga e drejta e trashëgimisë, noteri lëshon dëshminë e re të trashëgimisë, sipas parashikimeve të Kodit Civil, ku pasqyron ndryshimet në rrethin e trashëgimtarëve, pjesët e tyre takuese, si dhe të dhënat mbi aktin e heqjes dorë nga trashëgimia (ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, neni 117, para. 1).



6.2 Pyetje

- A e pranojnë trashëgiminë të gjithë trashëgimtarët?
- A heq dorë nga trashëgimia ndonjëri prej trashëgimtarëve?
- A ka shprehur ndonjëri prej trashëgimtarëve dëshirën që të heqë dorë nga trashëgimia brenda tre muajve nga çelja e trashëgimisë, dhe brenda gjashtë muajve nëse janë jashtë shtetit?
- A ka ndonjë shenjë që tregon se trashëgimtarët, të cilët synojnë të heqin dorë, janë sjellë sikur të mos kishin asnjë synim të hiqnin dorë nga trashëgimia e tyre?
- Cilat janë arsyet për heqjen dorë nga pasuria apo pjesa e trashëgimisë?
- A janë vënë trashëgimtarët që duan të heqin dorë, plotësisht në dijeni për pasojat e heqjes dorë nga trashëgimia e tyre?
- A ka ndonjë arsye për të besuar *prima facie* se heqja dorë nga trashëgimia nga ana e trashëgimtareve femra ka arsye në thelb diskriminuese?



6.3 Lista e dokumenteve/veprimeve

- ✓ Letërnjoftimi
- ✓ Deklarata me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e trashëgimisë para noterit

CONCLUSION

This guidance document has shown that in the course of conducting various legal transactions, notaries are principal actors in ensuring women's economic rights by giving legal effect to the will of the parties. The notaries shall comply with the legal framework in force, as well as proactively engage in informing parties of the content of drafted documents as well as the legal consequences. They shall ensure the presence and the consent of the spouse when conducting transactions involving the immovable property part of the community of property regime, as well as maintaining intact the share belonging to surviving spouses and daughters in inheritance proceedings.

The legal framework that regulates notarial activities is relatively new and provides the foundations for ensuring gender equality in land rights. However, the broader legal framework may need further improvement to contribute to gender equality in practice. For instance, there is no specific provision in the Civil Code and Family Code regulating the property regime or inheritance between partners in a civil partnership. Furthermore, there is no specific provision in the Civil Code granting user rights for life to the surviving spouse.

However, taking into consideration the existing legal framework, new ways of improving notarial practices may be explored in order to address the issues that undermine the enjoyment of land rights by women. For instance, notaries might need additional guidance in drawing the distinction between individually and jointly owned assets in cases of alienating property, or in cases of informing the surviving spouse of the right to request the separation of his/her share in the marital property from the deceased's estate. For this purpose, the legal framework on notaries might need to be supplemented with other regulatory measures. It is for the National Chamber of Notaries to ensure a common understanding of the existing legal framework and procedures by all notaries, as well as push the efforts to acknowledge that the protection of women's property rights in notarial practice needs special attention. In this regard, the new Law 110/2018 "On the Notary" and the Code of Ethics of the Notaries have established, for the first time, a fully-fledged system to conduct disciplinary proceedings against the misconduct of notaries. Moreover, according to the Law, a complaint may be filed with the court against any act or decision of the notary concerning the issuance, refusal to issue, correction of mistakes, change or revocation of a certificate of inheritance, pursuant to the rules for trying administrative disputes (Law 110/2018 "On the Notary," art. 97 para. 4). The proper application of the legal framework ensuring women's rights as outlined in this document, among others, should serve as a basis for assessment of the professional conduct of notaries. In order to anticipate any misconduct or misunderstanding of the correct implementation of such legislation, the National Chamber of the Notaries may undertake continuous training with notaries through the National Training Centre, in order to share best practices and highlight loopholes in ensuring women's rights in immovable property transactions.

This guide has been drafted in accordance with legal provisions as of June 2020, and should be subject to update by the National Chamber of Notaries in accordance with the revision of legislation.

KONKLUZION

Ky dokument udhërrëfytes tregoi se, gjatë kryerjes së veprimeve të ndryshme juridike, noteri është aktor kryesor për garantimin e të drejtave ekonomike të grave duke i dhënë fuqi ligjore vullnetit të palëve. Noterët zbatojnë kuadrin ligjor në fuqi dhe angazhohen në mënyrë proaktive për informimin e palëve mbi përmbajtjen e dokumenteve të hartuara, si dhe pasojat ligjore. Noterët sigurojnë praninë dhe pëlqimin e bashkëshortit/es gjatë kryerjes së transaksioneve ku përfshihet pjesa e pasurisë së paluajtshme nën regjimin e pasurisë në bashkësi, dhe gjatë procedurave të trashëgimisë ruajnë të paprekur pjesën takuese të bashkëshortëve/eve pasjetues/e dhe bijave.

Kuadri ligjor që rregullon veprimtaritë noteriale është relativisht i ri dhe parashikon bazën për garantimin e barazisë gjinore sa i takon të drejtave mbi tokën. Mund të jetë e nevojshme, gjithsesi, që kuadri më i gjerë ligjor të përmirësohet më tej që të kontribuojë për garantimin e barazisë gjinore në praktikë. Kodi Civil dhe Kodi i Familjes, për shembull, nuk përmbajnë asnjë dispozitë të veçantë për rregullimin e regjimit të pasurisë apo trashëgiminë midis partnerëve në një partneritet civil. Kodi Civil, për më tepër, nuk përmban asnjë dispozitë të posaçme që i jep bashkëshortit pasjetues të drejtat e përdoruesit për jetë.

Duke marrë në konsideratë kuadrin ligjor ekzistues, sidoqoftë, mund të hulumtohen rrugë të reja për përmirësimin e praktikave noteriale me qëllim trajtimin e çështjeve që cenojnë gëzimin e të drejtave mbi tokën nga gratë. Për shembull, noterët mund të kenë nevojë për udhëzime plotësuese për të bërë dallimin midis sendeve të zotëruara individualisht dhe bashkërisht në rastet e tjetërsimit të pasurisë, ose në rastet e informimit të bashkëshortit pasjetues mbi të drejtën për të kërkuar ndarjen e pjesës së vet në pasurinë e fituar gjatë martesës nga pasuria trashëgimore e personit të vdekur. Për këtë qëllim, mund të jetë e nevojshme që kuadri ligjor për noterët të plotësohet me masa të tjera rregullatore. I takon Dhomës Kombëtare të Noterëve të sigurojë që kuadri dhe procedurat ligjore ekzistuese të kuptohen njësoj nga të gjithë noterët, si dhe të nxisë përpjekjet për të pranuar se mbrojtja e të drejtave pasurore të grave në praktikën noteriale kërkon vëmendje të posaçme. Në këtë aspekt, ligji i ri nr. 110/2018 “Për noterinë” dhe Kodi i Etikës së Noterëve, për herë të parë, kanë krijuar një sistem të plotë të kryerjes së procedurave disiplinore ndaj shkeljeve në punë të noterëve. Përveç kësaj, sipas ligjit, ndaj çdo veprimi ose vendimi të noterit për lëshimin, refuzimin e lëshimit, ndreqjen e gabimeve, ndryshimin a shfuqizimin e dëshmisë së trashëgimisë, mund të bëhet ankim në gjykatë, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative (ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, neni 97, para. 4). Zbatimi si duhet i kuadrit ligjor që garanton të drejtat e grave siç parashtrohet në këtë dokument, duhet të shërbejë, ndër të tjera, si bazë për të vlerësuar sjelljen profesionale të noterëve. Për t’i paraprirë ndonjë shkeljeje a keqkuptimi të zbatimit me korrektësi të këtij legjislacioni, Dhoma Kombëtare e Noterëve mund të ndër marrë trajnime të vazhdueshme të noterëve përmes Qendrës Kombëtare të Trajnimit, me qëllim që të shkëmbehen praktikat më të mira dhe të evidentohen boshllëqet për garantimin e të drejtave të grave në transaksionet me pasuritë e paluajtshme.

Ky udhëzues është hartuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi nga muaji qershor 2020, dhe duhet të jetë objekt përditësimi nga ana e Dhomës Kombëtare së Noterëve, në përputhje me rishikimin e legjislacionit.

LIST OF LAWS AND COURT DECISIONS

Laws

Constitution

Family Code

Law 110/2018 “On the Notary”

Law 111/2018 “On the Cadastre”

Law No. 9970 of 24.07.2008 “On Gender Equality in Society”

Law No. 10 221 of 4.2.2010 “On Protection against Discrimination”

Law No. 8137, of 31.7.1996 The Civil Code

Law No. 7767 of 09.11.1993,

Law No. 9052 of 17.04.2003

Code of Ethics of Notaries, art. 5 para. 7, adopted by the Order of Minister of Justice No. 444 of 30.09.2019 published in the *Official Journal* No.142/2019

Law No. 8438, of 28.12.1998 “On Income Tax” (amended)

Court Decisions

Supreme Court Joint Chambers Decision No 1 of 2014

Supreme Court Joint Chambers Decision No. 24 of 2002

Supreme Court Joint Chambers Decision No. 1 of 18.12.2014

Supreme Court Civil Chamber Decision No. 488 of 18.12.2008

Tirana First Instance Court Decision No. 3873 of 09.05.2016

International legal instruments

CEDAW: Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women (adopted on 18 December 1979)

CEDAW-OP: Optional Protocol to the Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women (adopted on 06 October 1999)

European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms (adopted on 4 November 1950)

Bibliography

- FAO and GIZ. *Guidelines on Strengthening Gender Equality in Notarial Practices – South-East Europe*, Rome, 2019.
- Mandro, A. *Property rights of women spouses- a short overview of challenges of gender equality and non-discrimination in the marital property regime, in Rights of women in relation to the commercial activity as part of the legal community property regime: A comparative perspective of the Albanian legislation and jurisprudence with selected European jurisdictions*, eds. Mallezi, Rystemaj, Kromici, Dea Print, Tirana. 2018. Available at: <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania/al-cpf-2015-eng.pdf>
- Nuni, A. and L. Hasneziri. *Collection of lectures on property and inheritance*. 2008.
- Omari.
- Qarri, E.
- UN. *Albania Gender Brief*. 2016. <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief#view>
- UN Women. *Women's property rights in Albania, An analysis of the legal standards and their application*. Second Edition. 2016. http://www.un.org.al/sites/default/files/WOMEN%E2%80%99SPROPERTY%20RIGHTS%20IN%20ALBANIA_0.pdf
- World Bank. *Country Partnership Framework for Albania 2015-2019*, Report Number: 94636-AL, 2015. <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania/al-cpf-2015-eng.pdf>

LISTË E LIGJEVE DHE VENDIMEVE GJYQËSORE

Ligje

Kushtetuta

Kodi i Familjes

Ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”

Ligji nr. 111/2018 “Për kadastrën”

Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”

Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996 Kodi Civil

Ligji nr. 7767 datë 9.11.1993 (titulli i ligjit – shën i përkth)

Ligji nr. 9052 datë 17.04.2003(titulli i ligjit – shën i përkth)

Kodi i Etikës së Noterëve, neni 5, para. 7, miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 444, datë 30.09.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr.142/2019

Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar)

Vendime gjyqësore

Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1, 2014

Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 24, 2002

Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 18.12.2014

Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 488, datë 18.12.2008

Vendim i Gjykatës së Faktit të Tiranës nr. 3873, datë 9.05.2016

Instrumente ligjore ndërkombëtare

CEDAW: Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (miratuar më datë 18 dhjetor 1979)

CEDAW-OP: Protokoll i Fakultativ i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (miratuar më datë 6 tetor 1999)

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (miratuar më datë 4 nëntor 1950)

Bibliografi

FAO dhe GIZ. Udhëzues për Garantimin e Barazisë Gjinore në Praktikën Noteriale – Evropa Juglindore. Romë, 2019.

Mandro, A. Të drejtat pasurore të bashkëshorteve gra – përmbledhje e shkurtër e sfidave lidhur me çështje të barazisë gjinore dhe jodiskriminimit në regjimin pasuror martesor, tek të drejtat e grave lidhur me veprimtarinë tregtare në kuadër të regjimit ligjor të pasurisë në bashkësi: Këndvështrim krahasues i legjislacionit dhe jurisprudencës shqiptare me disa juridiksione evropiane, redaktorë: Malltezi, Rustemaj, Kromici, De Print, Tirana, 2018. Gjetet në adresën: <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania/al-cpf-2015-eng.pdf>

Nuni, A. dhe Hasneziri, L. Përmbledhje e leksioneve mbi pasurinë dhe trashëgiminë. 2008.

UN. 2016. Raport mbi trajtimin e barazisë gjinore në Shqipëri. <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief#view>

UN Women. Të drejtat pasurore të grave në Shqipëri – analizë e standardeve ligjore dhe zbatimit i tyre. Botimi i dytë. 2016. http://www.un.org.al/sites/default/files/WOMEN%E2%80%99SPROPERTY%20RIGHTS%20IN%20ALBANIA_0.pdf

Banka Botërore. Kuadër i partneritetit kombëtar për Shqipërinë 2015-2019, numri i raportit: 94636-AL, 2015. <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania/al-cpf-2015-eng.pdf>



ISBN 978-92-5-134524-5



9 789251 345245

CB5023B/1/07.21